



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 23 dhjetor 2013, në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës

Mbledhja filloi në orën 10.00' dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit z. Vehbi Rushiti,

Në mbledhje të pranishëm ishin z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Isak Ejupi, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal, përfaqësues të institucioneve të Komunës, përfaqësues të KFOR-it, z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së, përfaqësues të Komuniteteve, përfaqësues nga Organizata të ndryshme Joqeveritare, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

Fillimisht u bë intonimi i himnit shtetëror.

1. Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga këshilltari më i vjetër i Kuvendit

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, zotëri Kryetar i Komunës, anëtarë të certifikuar, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, ju njoftoj se sipas të dhënave të cilat i posedon Zyra për punë të Kuvendit, unë Vehbi Rushiti, i lindur më 05.08.1944, jam anëtari më i moshuar në përbërjen e certifikuar në bazë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 3 nëntor 2013.

Duke u bazuar se rregullat e kërkojnë që të verifikohet mosha e anëtarit më të vjetër për të kryesuar me këtë mbledhje, ju pyes se a ka ndonjë anëtar më të moshuar se unë.

Ju lutem lajmërohuni nëse ka ndonjë këshilltar më të vjetër.

Meqenëse askush nuk u lajmërua, kryesuesi i mbledhjes konstatoi se pa vërejtje u verifikua anëtari më i moshuar i Kuvendit.

Në vazhdim z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes shtoi, zotëri Kryetar i Komunës, anëtarë të Kuvendit, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, në bazë të nenit 42. 5 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale e hapi Mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Zonja dhe zotërinj, vazhdoi kryesuesi i mbledhjes, jeni në dijeni se më 8 dhjetor 2013 ndërroi jetë Qefser Sadiku, anëtar për tri mandate i Kuvendit të Komunës, në mandatin

e fundit shef i Grupit të anëtarëve të LDK – së dhe anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, i zgjedhur anëtar edhe në mandatin e ri.

Në respekt të veprës dhe shëmbëlltyrës së tij, Ju ftoj të nderojmë me një minutë heshtje.

Mbahet një minutë heshtje.

Në vazhdim pas thirrjes emër për emër u konstatua se të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e certifikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor përkatësisht se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes.

2. Ngritja e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, lidhur me këtë çështje propozimi im është që Komisioni të përbëhet prej tre anëtarëve nga partitë politike me numrin më të madh të anëtarëve që përfaqësohen në këtë Kuvend.

Ju lutem a pajtoheni me këtë propozim

Propozimi i kryesuesit të mbledhjes u miratua njëzëri.

LDK për kandidat në kuadër të komisionit propozoi z. Mehmet Gashin, PDK z. Naim Çunakun, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje z. Haki Rudarin.

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, Ju lutem me ngritjen e dorës deklaroni se a pajtoheni me propozimet e paraqitura.

Në vazhdim u konstatua se njëzëri u ngrit Komisioni i përkohshëm për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, në përbërje:

1. z. Mehmet Gashi
2. z. Naim Çunaku
3. z. Haki Rudari

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, kërkoi nga Komisioni që të bëjë verifikimin e mandatit të këshilltarëve dhe të paraqes raportin përkatës.

3. Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit

z. Mehmet Gashi, në emër të Komisionit raportoi se në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendeve Komunale 2013 të nr. 2324-2013 të datës 12.12.2013 dhe Listës së bashkëngjitur të këtij Vendimi është bërë certifikimi i përbërjes së Kuvendit listë e njëjtë me atë që u thirren anëtarët e Kuvendit me rastin e konstatimit të kuoromit për mbajtjen e mbledhjes, ndërsa me Vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor nr. 2406-2013 të datës 17.12.2013, z. Enver Bunjaku është emëruar anëtar i Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politik LDK, duke e zëvendësuar të ndjerin Qefser Sadikun.

4. Betimi solemn i këshilltarëve të Kuvendit

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, zonja dhe zotërinj këshilltarë ju përkujtoj se Betimi solemn i këshilltarëve bëhet bashkërisht dhe unë e lexojë pjesë pjesë tekstin i cili përsëritet në mënyrë të zëshme nga këshilltarët, me të vetmin ndryshim që pas fjalës unë çdo këshilltar e thotë emrin dhe mbiemrin e vet.

ju ftoj të japim betimin solemn.

Betimin e dhanë:

Agim Kikaj.....	LDK
Fidan Rekaliu.....	LDK
Liridona Shabani.....	LDK
Agron Hyseni.....	LDK
Fatlume Jaha.....	LDK
Fatmir Gashi.....	LDK
Mynavere Abdullahu – Krasniqi.....	LDK
Bahri Blakçori.....	LDK
Mehmet Gashi.....	LDK
Afrim Shabani.....	LDK
Islam Revuçi.....	LDK
Kadrije Mulolli.....	LDK
Vehbi Rushiti.....	LDK
Afërditë Lutfiu.....	LDK
Enver Bunjaku.....	LDK
Xhevdet Beselica.....	PDK
Rafet Llapashtica.....	PDK
Endrite Murati.....	PDK
Kadri Avdiu.....	PDK
Sabri Hamiti.....	PDK
Ismail Krasniqi.....	PDK
Flakron Gashi.....	PDK
Fatmir Rudari.....	PDK
Naim Çunaku.....	PDK
Burbuqe Rrahimi.....	PDK
Kumrie Hoti.....	PDK
Floriqe Maliqi.....	PDK
Bahri Selimi.....	LVV
Haki Rudari.....	LVV
Adelinë Stublla.....	LVV
Lutfi Rexhepi.....	AAK-LDD
Mirsad Kamerolli.....	AAK-LDD
Mrika Thaçi.....	AAK-LDD
Bashkim Statovci.....	AKR
Nexhat Llumnica.....	LB

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, nënvizoi, tani edhe zyrtarisht jeni këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, urime dhe punë të mbarë.

Pas dhënies së betimit anëtarët e Kuvendit e nënshkruan tekstin e betimit .

5. Betimi solemn i Kryetarit të Komunës

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, tani e ftoj z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës të jap betimin solemn

Pas dhënies së betimit solemn z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, e nënshkroi tekstin e betimit.

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, nënvizoi, urime zotëri Kryetar, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese.

6. Fjala e rastit e z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuar z. Kryesues i kësaj seance inauguruese, të nderuar këshilltarë të përbërjes së re të Kuvendit, Këshilltarë që përmbyllët mandatin a mandatet, miq e mysafirë, institucione, medie, zonja dhe zotërinj, sapo solemnisht edhe formalisht Ju, tashmë, po filloni mandatin 4 vjeçar në Kuvend, log ky i demokracisë dhe i maturisë politike; nga këtu marrin udhë nismat, zhvillohet diskutimi e debati në funksion të zgjidhjeve dhe miratohen Rregullore e bihen Vendime.

Në krye të herës, falënderimi ynë për Votuesit që na besuan edhe këtë mandat e për të disatën here si vlerë e përkushtim dhe për angazhimin e rezultatet në qeverisjen në Podujevë, nivelin e mirëqenies dhe standardin e procesit demokratik këtu. Edhe njëherë, zotohemi se do ta përmbushim obligimin tone ndaj qytetarëve dhe votuesve pa luhatje e vendosmërisht.

Para Jush, anëtarë të nderuar, në Kuvendin e Komunës, edhe unë, në cilësinë e Kryetarit të Komunës, deklarova, jo vetëm formulën, por edhe vullnetin dhe përkushtimin e pa lëkundur në realizimin e politikave, objektivave dhe të projekteve që, rrisin mirëqenien, avancojnë cilësinë në dhënien dhe marrjen e shërbimeve, në respekt të ligjit e të publikut, për të gjithë qytetarët.

Zonja dhe zotërinj këshilltarë, dua të marrë nga ky rast që, këshilltarëve nga përbërja e kaluar, e në respekt dhe obligim të kontributeve të çmuara që ata i kanë dhënë këtij organi dhe jetës demokratike në Podujevë, t'u shpreh konsideratën e merituar për angazhimin, konstruktivitetin dhe produktin e vyer në mandatin a mandatet e kaluara, e ku ata kanë frymën dhe vulën e tyre.

Anëtarë të nderuar të Kuvendit të ri, Qytetarë të Llapit, me ju, në Kuvend, do diskutojmë gjithë çfarë e thotë germa dhe fryma e ligjit, çdo akt politik, rregullativ a vendim që targeton interesin e qytetarit, dhe që i jep rastin e shansin konsensusit, deri në vendosje e në respekt të përgjegjësisë dhe afateve.

Kam besimin se, tani më, kemi arritur maturinë e nevojshme për domosdonë e bashkëpunimit e, në shërbim të publikut dhe privatit qytetarë.

Urimin për suksesin në mandatin tuaj dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, i shtoj urimin për Vitin e Ri – Gëzuar në paqe, me shëndet e mirëqenie.

Faleminderit

Mbledhja përfundoi në orën 10.25'

Procesverbalin e mbajtën

Faik Gashi

Enis Sheholli

Nr. 01-006-32503

Podujevë,

23 dhjetor 2013

Kryesuesi i mbledhjes

Vehbi Rushiti